



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

|                                        |            |            |           |
|----------------------------------------|------------|------------|-----------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA |            |            |           |
| KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA       |            |            |           |
| Pronuar - Prilijena tsh/ana            |            | 19-07-2020 |           |
| Nr./ organit                           | Numri/Broj | Shitje     | Vlera     |
| Org.broj                               |            | Prilog     | Vrednosit |
| 01-060/01-502                          |            |            |           |



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42 paragrafi 42.3 i Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr 01-013/594, e datës: 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

### F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e -VI-, të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë: **23.07.2020 ( e Premte)**, duke filluar në ora 10,00.

Mbledhja do të mbahet në zyrën e konferencave tek objektin i ri i Komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

### R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2021
3. Propozim vendim për caktimin e komisionit për intervestim, vlerësim dhe poentim të kandidateve të cilët kanë konkuruar në konkurset publike për pozitë drejtor, zv drejtor të shkollave fillore- mesme dhe qerdheve të fëmijëve të Komunës së Vitisë

Viti, më 19.07.2020

Me respekt !

Kryesuesi i Kuvendit

Naim Pira







Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E PESTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoj, z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **21.06.2021 (e Hënë)**, në zyrën e konferencave në objektin e ri të komunës, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal), znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen,

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Më lejoni të ju përshëndes! Përshëndesë nënkryetarin e Komunës, ju anëtar të KPF-së, drejtorët që janë sot prezent, ju të gjithë të pranishëm që jeni në këtë mbledhje! Muajin e kaluar nuk kemi pasur seancë për faktin që nuk kemi pasur pika për me mbajt mbledhje. Diçka të veçantë nuk kemi, përpos konfirmimit të ligjshmërisë së akteve që janë dal nga seanca e fundit. Ju falënderoj gjithëve për kontributin e dhënë! Ndoshta është me interes të ju tregojmë se, kemi zero raste me Covid 19, kështu që, i falënderojmë gjithë akterët që kanë kontribuar në këtë drejtim, si: stafin mjekësorë, policinë, stafin emergjent, si dhe qytetarët për një vetëdijesim dhe kulturë të treguar gjatë kësaj periudhe. Urojmë që mos të përsëritet kjo e keqe më! Diçka tjetër nuk kam për të shtuar, atëherë kalojmë në pyetje jashtë rendit të ditës. A ka dikush me shtuar diçka?

**znj.Gjylsime Qamili:** Pasi që vij nga sfera e shëndetësisë, dhe besoj që edhe juve ju intereson, edhe se në FCB drejtoresha, Vjollca Kadolli i rrin gati çdo informate, e plason dhe ju jep informatë në lidhje me vaksinat. Kryesuesi e dha informatën se, nuk kemi pacient me Covid 19, por as aktiv nuk kemi, mirëpo informata ime është për vaksinimin. Gjithsesi janë dhanë 2657 vakcina, kemi vakcina me sasi të mjaftueshme, vaksinimi është ka bëhet në mënyrën ma të mirë të mundshme, duke ju falënderuar edhe doktorëshës Vjollcë, po e potencoj edhe një herë, që është duke e bërë një menaxhim perfekt. Ambienti është i mirë, në rast se jeni të interesuar ta dini se cila kategori tash është ka vaksinohet, ato janë: policia, arsimi, të moshuarit mbi 65 vite dhe të sëmurit kronik, por gjithsesi duhet të kenë dokumentin.

**Kryesuesi, z.Naim Pira:** Ju faleminderit për punën që keni bërë! Njeri prej tyre edhe unë jam që i kam marr dy dozat e vaksinave. Ju jam falënderues! Dikush tjetër a ka diçka?

**z.Bekim Azizi:** Ju përshëndes të gjithëve që jeni prezent në këtë mbledhje! Kisha një pyetje: a ka filluar zbatimin i këtij vendimi që e kemi marr, kompensimin i familjeve që kanë humbur anëtarët e familjeve me Covid 19. E di, ka familje që me kanë thanë, që kanë aplikuar që një kohë edhe nuk ju kanë lëshuar mjetet. Vetëm dua të di: a ka filluar zbatimin i këtij vendimi rreth pagesave?

**z.Ibrahim Rama:** Po, i nderuar! Në Ministrinë e Financave, gjegjësisht në drejtorinë e thesarit na e kanë kërkuar listën me kaluar, 50 personave që kanë pasur vdekje prej Covidi. Na tash i kemi bërë 51 që janë të vdekur, e kemi bërë CD-në, e kemi bërë listën, zotimi bëhet sot, eventualisht nesra për të gjithë këta 51 që kanë pasur vdekje nga Covidi.

**znj.Hidajete Pira:** Kisha pasur një pyetje: pse nuk po funksionojnë semaforët te rruga e Pozheranit? Edhe po më intereson me ditë, ajo rrugë që është Gërlicë – Ferizaj: a i takon nivelit regjional apo nivelit komunal? Unë s



kam informata, inspektorat e kanë pa të pa aksyeshme vendosjen e semaforëve. E njëjta është e niveli regional, pse janë harxhuar pare pa nevojë për ata semaforë.

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Më lejoni të ju përshëndes gjithëve të pranishmeve! Rruga i takon aspektit regional, por plani i mobilitetit e ka paraparë me ndërmarr diçka aty. Bile ka qenë e paraparë rrethrotullim, apo ishull dhe rrethrotullimi kërkonte shpronësim. Në pamundësi komuna me bërë, kemi menduar që semaforët do të jenë zgjidhja ma e mirë dhe janë vendosur semaforët. Unë kam qenë idhtar i vendosjes së rrethrotullimit. Ne e kemi diskutuar shumë herë edhe në kuvend, për shkak të rrezikshmërisë që ka paraqitë ai udhëkryq. Aty, për sa ti kish ndreq Prishtina, atë harroje se nuk i kish ndreq kurrë.

**z.Ekrem Abazi:** Unë qysh e kam parë nga këndi im, fajtor kryesor është ai që i ka vendosur aty semaforët, se pritjet ma të gjata janë në rrugën kryesore, se në ato anësore unë kam qëlluar rastësisht aty dhe e kam parë që është e pamundur me bërë sinkronizimin

**z.Ibrahim Rama:** Harmonizimi i kohës bëhet për gjysmë ore. Problemi është te radhitja për me funksionuar semaforët mirë. Kur hapet për Ferizaj mbyllet për në Pozheran. Ky i Pozheranit e pengon, për shkak se duhet të jetë edhe një trakë ndihmëse, që me pas mundësi me hecë ana e djathtë ose ana e majtë.

**z.Jakup Demiri:** Ne e kemi marr atë në kadastër dhe krejt ato shtëpia janë në pronë publike. Aty kish hapësirë me bërë rreth e gjithë. Ne e kemi ditë se aty semaforët nuk funksionojnë.

**z.Bekim Azizi:** Është keq kjo që tha drejtori se, është dashtë edhe një shirit. Problemi është pse u vendosen semaforët pa e shqyrtuar këtë çështje, që a banë me i vendosur a nuk banë. Na e dimë se qarkullimi në rrugën regjionale ka qarkullim shumë ma shumë se rruga e Pozheranit. Do me thanë, kjo është dashtë të shqyrtohet ma herët, a ka mundësi të funksionoj, a ka mundësi me i vendosur shiritat shtesë, mënyra e funksionimit. Ajo është tu bë moment që dhezët drita vezulluese aty. Çështja e aksidenteve. Ato janë pa përgjegjësi, ato ndodhin edhe në semaforë te vendosur thjeshtë, vendosja e atyre semaforëve ka qenë gabim dhe aty nuk kanë me funksionuar asnjëherë.

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Desha të lidhem te Jakupi, kur e cekim kadastrin. Ti e dinë çfarë kadastri kemi në nivel të Kosovës, jo vetëm në Viti, ka mungesë të dokumentacionit. Unë diku i kam 58-59 vite dhe dajmë i kam parë ato shtëpia ashtu. Tash, a ka uzurpim unë nuk e di. E dyta, Bekimi e tha në lidhje me semaforë. Unë e kam thënë edhe e mbroj atë, unë nuk thash që e kam mirë, nuk ka autoshkollë që vepron në Viti që ke mujt me realizuar praktikisht një nxënës me dal me pa semaforët. Ja u dashtë me qu në Ferizaj ja në Gjilan. Në këtë kontest e kam thanë dhe e them serish.

**Kryesuesi, z.Naim Pira:** Kjo është një temë tjetër me hy në shpronësime, sepse këtu duhet me pas njerëz të lamisë që duhet me u marrë me atë çështje që kanë bërë verifikime dhe që dinë me bë matjen.

**z.Ekrem Abazi:** A jeni duke punuar për këtë punë, a është tu marr dikush që të funksionalizohën ata semafor?

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Krejt jemi duke punuar, që ata semaforë të jenë funksional!

**Kryesuesi, z.Naim Pira:** Është me interes me tregu se, për shëfat e grupeve parlamentare, me 24 dhe 25 të këtij muaji, në Gjilan është një trajnim i organizuar nga ana e DEMOS-it, me tema të ndryshme. Kush ka mundësi është mirë me marr pjesë në atë trajnim. Ju faleminderit! Tash për këtë seancë të KPF-së, kemi paraparë këtë:

## R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizën afatmesme buxhetore (KAB), të Komunës së Vitisë 2022-2024.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim-plotësimit të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbështetje financiare për shpenzimet e strehimores "Liria" në Gjilan, për një periudhë trevjeçare, 2021-2022-2023.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2022.



A ka dikush rreth pikës së parë të rendit të ditës ju lutem? Pasi që nuk ka, e hedhi në votim për miratim të ditës. Konstatohet se me vota unanime miratohet rendi i ditës.

Si pikë të parë kemi:

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Komitetit për Politikë dhe Financa**

A ka dikush rreth pikës së parë të rendit të ditës ju lutem? Pasi nuk ka, e hedhi në votim për miratim. Konstatohet se me vota unanime u miratu pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë kemi:

**2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë, 2022-2024**

Ja kaloj fjalën drejtorit rreth kësaj pikë të rendit të ditës.

**z.Ibrahim Rama:** Na, pjesa dërmuese që sa mandate jemi në dijeni që ka të bëjë me Kornizën Afatmesme Buxhetore, 2022-2024. Do të mundohem në pika të shkurtra për me ju dhanë juve rrugë për debat, që fillimet i ka prej qarkores së parë buxhetore, që është ardhur nga Ministria e Financave. Ky është hapi i parë rreth draftimit të buxhetit në Komunën e Vitisë për vitin 2022 edhe projeksionet 2023/2024, është proces në të cilën na me qarkoren e parë duhet me i caktuar kufijtë maksimal, sa ka buxhet komuna e Vitisë për vitin 2022 dhe viteve tjera. Këto janë fillet që kemi me ba na deri me 30 shtator. Buxheti është dokument kryesor edhe kemi mbajt debate të shumta nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe nga qytetarët. Na kemi filluar vetëm me përgatitur, na e kemi shpjeguar shumë herë se, buxheti ndahet në komisione. Janë ato kritere bazë që janë hala në fuqi. Te shumica e drejtorisë kemi rritje. Vlen të ceket se, kemi rritje ma të theksuar. Kjo ishte në pika të shkurtra. Për mos me ju marr kohë ma shumë po ja lam juve që të shtroni pyetje apo sugjerime rreth KAB-it.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Faleminderit drejtor! Është e vërtetë se KPF-ja kemi menduar me mbajt një takim rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore, tu e ditë që është si kornizë, por duke pas për bazë faktin se edhe vitin 2019 e kemi mbajt një takim, dhe prezent ka qenë vetëm Jakupi, unë kam pritë që të mbahet kjo mbledhje dhe ka e premtja ta mbajmë një takim edhe se pjesëmarrja po është shumë e vogël, por pasmi trajnim në Gjilan. Do të ju njoftojmë për një datë të përshtatshme. Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutem.

**z.Jakup Demiri:** Ky material ofron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit. Kjo është e kuptueshme. Ku po dua me dal. Te investimet që bëhen drejtor. Një ndër nevojat kryesore të qytetarëve janë kanalizimi edhe uji i pijes, kur na e dimë se këtë vit Komuna e Vitisë nuk ka ndarë asnjë mjet për këto dhe për parashikimet për dy vitet e ardhshme nuk ka të parapamë. Tjetër. Te zhvillimi ekonomik, Viti, nëpër të cilën kalon lumi “Morava e Binçës” shtrihet në pjesë qendrore të fushë gropës së “Moravës së Epërme”, lumi “Morava e Binçës”, në të cilën derdhen edhe lumi “Letnica”. Ka një rendësi të madhe ekonomike, me që mundëson ujitjen e tokave, ndonëse konsiderohet njëra ndër komuna ma të pazhvilluara të Republikës së Kosovës, me një infrastrukturë të kënaqshme rrugore, por jo edhe me rrjetin e ujësjellësit. Edhe vet e dini që nuk i keni punët mirë me ujësjellës dhe kanalizim. Te puna e çerdheve në Viti. Po përfundon mandati 4 vjeçar i kryetarit Sokol Haliti dhe kemi vetëm një çerdhe publike. Premtimet kanë qenë për katra, nuk është bërë asnjë. Te inspektimi. Në vitin 2021 kemi 2400 euro, kurse inspektime për vitin 2022 kemi 600 euro. Nuk e di pse është kjo kështu. Edhe gjrobat nga inspeksioni janë të njëjtat, te inspektimi sanitar i kemi 1200 euro, erdhëm në 360 të të hyrat vetanake të komunës. Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale. Këtu te investimet kapitale, nëse shkojmë si viteve të kaluara, prapë kemi bërë asgjë. Te shpenzime kapitale, pa e përcaktuar asnjë investim kapital se ku ka me shkuar votohet, na e dimë qysh kalon në kuvendin komunal. Veç kam informatë se, këtë vit ashtu nuk kanë me kaluar në ministri, se na i ndajmë 21% të buxhetit pa e përcaktuar askush. Nuk e dinë përveç kryetarit, as ju nuk e dini se ku kanë me shkuar qeto pare. Ku ke puna e shpronësimit, po ka mundësi me i qit punëtorët e komunës me shpronësuar për me asfaltuar, a nuk kanë mundësi me i qit në hyrje të Vitisë ku marohen semaforët në pjesën ma të dendur të rrugës, e kjo është e pafalshme. Sipas KDI së, kur the se na qëndrojmë mirë si Viti me numrin e mësimdhënësve, sipas KDI-së, aty e përmend Vitin dhe Kamenicën që kanë numër të madh të punëtorëve arsimor dhe pranojnë hala. Në vitin 2021 kanë 204 nxënës m pak dhe kanë disa punëtor që janë me gjysmë norme dhe nuk i plotësojnë këto norma po shpallin konkurse të reja



te zyta e kryetarit kishte mije. Eshte e kaptesime se si vit zgjedhjet projekti kapitale te komunës dhe kostoja duhet te përgatiten pas dëgjimeve publike buxhetore. Këtë e kemi cekur. The se janë mbajt ka 26 dëgjime buxhetore të viteve të tjera. Unë po them se nuk është mbajtur asnjë, nuk janë ato dëgjime buxhetore. Para dy viteve unë kam qenë në dëgjim buxhetor në Viti, këtu i vetmi jam kanë unë edhe atë kam marr pjesë si asamblist, e keni mbush me punëtor të komunës me bë një foto. Ai nuk është dëgjim publik, ndërsa kur u zgjedhshin administratorët e fshatrave, më kujtohet p.sh. shkolla në Sllatinë, 569 njerëz në shkollë me zgjedh administratorin. Ne si fshat i kemi dorëzuar 5 prioritetet të fshatit, asnjëri nuk ka gjetur zbatim. Komuniteti kërkon diçka tjetër, a investimet vinë krejt tjetër sene. Për ata investimet kapitale duhet të përcaktohen para se me u votuar, se për me votuar buxhetin ju keni shtu edhe njerëz nëpër puna. Ma shumë njëherë nuk kam.

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Ma shumë në aspektin shoqëror, gjuhen e kërcënimit duhet me hekë. Është një lloj gjuhe e kërcënimit, kur thua deri tash ja ka aprovuar ministria, e tash e tutje nuk ja aprovon. A e dinë pse po e them këtë. Unë po e them në aspektin racional këtë, në kuadër të ligjit na i kanë aprovuar, kanë me na i aprovuar edhe këta.

**z.Jakup Demiri:** Nuk është gjuhë kërcënuese ma e madhe se mi dhanë parët e qytetarit për vota. Ke shtruar asfalt nëpër oborre.

**z.Ekrem Abazi:** Unë desha me pyet, 200 punëtor të arsimit kokan tepër. A ka mundësi me ditë sa punëtor të arsimit janë më gjysmë norme dhe si do të vepron me ta. Te Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. D.m.th. asistencën sociale pa të ardhura dhe të ardhura të ulëta. Dua të di ku keni ndihmuar aty. Te shëndetësia, pak ka rritje, si e pash unë shuma e përgjithshme e buxhetit nuk ka rritje po ka zvogëlim për 10 mijë euro si e pash unë. Te pagat në vitin 2021, janë 991185 euro; në vitin 2022 janë 952275 euro. Ka për 40 mijë euro ma pak. A e keni parapa me zvogëluar numrin. Planifikimi i të hyrave komunale sipas kategorive, te ofiqari 2 mijë euro kanë qenë ne vitin 2021, a tash 3960 është një diferencë e madhe. Ose kurorëzimet 9600 euro. a në vitin 2022, 3960 euro. Shfrytëzimi i hapësirave publike 3500 euro në vitin 2021, a 7492 euro në vitin 2022. Te tatimi në pronë 439579 euro për vitin 2021, ndërsa për vitin 2022 janë 592320 euro. Rritja e përgjithshme është bërë për 126 mijë euro, a veç te tatimi në pronë janë bërë 152 mijë euro rritje për vitin që vjen. Për fillim kaq kam.

**z.Bekim Azizi:** Kjo është një pikë shumë e rëndësishme. Një pjesë vetëm e folën parafolësit e mi. Tash qarkorja e parë është për miratim të buxhetit. Mendoj se kësaj radhe do të jeni ma bashkëpunues, sepse kemi edhe zgjedhjet këtë vit. A ka pas vërejtje, sa dush kemi dhanë edhe ne vërejtje edhe herëve të tjera. Hera parë është te shkrimet, përcillni se keni gabime. Çdo vit e njëjtë është te pjesa e subvencioneve, luan diku 2 mijë euro. Çështja e arsimit është problem shumë që një kohë të gjatë. E dimë tash edhe ne bazë të statistikave që i kanë paraqitur atje dhe kemi 39% e nxënëseve ma pak në Komunën e Vitisë, kurse personeli është rritur 11%. Te kategoria mallra dhe shpenzime. Edhe vet e the se është problematikë kryesore për numër të nxënëseve, që i bien 40 euro për një nxënë. Aty hyn gjitha shpenzimet. Kjo është një shumë e vogël edhe kemi probleme ma të ndryshme. Kemi edhe te kopjet që është elementare. Unë mendoj nëse ka hapësirë kjo kategori të jete ma e madhe. Për çështjen e shëndetësisë, e përmendi edhe Ekremi, nuk e di sa janë të mjaftueshme. Te shpenzimet kapitale nuk kemi të shkruar asgjë, por unë mendoj se, kësaj radhe do të jemi pak ma serioz. Unë mendoj se, duhet t'i cekim veç e veç, jo me shkua në të përgjithshmen, me ditë ku ka kanalizime, ku ujësjellës apo asfaltime. Duhet me ditë ma saktësisht ku po shkojnë ato investime. Edhe një pyetje. A keni menduar tash kjo paga jubilarë me konteste gjyqësore, që ka me na i dëmtuar kjo shume buxhetin e viti të ardhshëm.

**Kryesuesi, z.Naim Pira:** Ju faleminderit të gjithëve për pyetjet të cilat i ngritët për këtë pikë të rendit të ditës. Tash ja kaloj fjalën drejtorit.

**z.Ibrahim Rama:** Pa marr parasysh cilit subjekt i takoj, buxheti është një ligj. Shpërndarja e buxhetit. Ato janë kompetenca të atij ekzekutivi që është në fuqi. Pjesë tjetër që duhet të merret për bazë buxheti, është plani zhvillimor komunal, strategjia komunale. D.m.th. krejt dokumentet duhet të marren për bazë. Po filloj prej pyetjeve që parashtroj Jakupi, te kanalizimet dhe ujësjellësi. Është nënshkruar një marrëveshje mes kryetarit të komunës, KDI-së dhe "Hidro Moravës". Kanë me i investuar 40 ujësjellës në nivel komune. Aty komuna ka me participu me 390 mijë euro dhe një marrëveshje tjetër është në përfundim me CDI-në dhe "Hidro Moravën" për 8, me ujësjellës të ri. Me këto dy marrëveshje kemi me mbërri diku 800 mijë euro. Sa i përket kanalizimeve, i kemi edhe me KAB-in. Kemi me pas një shumë të konsiderueshme për investime të kanalizimeve. Sa i përket çerdheve. Na një e kemi në



perumimin, e kemi me te perumimin e asaj qerane ne qumak. Disa pyetje tash jane te perbashteta. Po mundohet te ju pergjigjem te hyrat. Na i caktojme listat qe i kanë prioritet drejtorite. Shumën e të hyrave vetanake na i përcakton ministria, 980 mijë euro te tatimi në pronë. Po lidhem me Ekremin. Këto i cakton Ministria e Financave. Me qarkore të Ministrisë së Financave, investimet kapitale. Edhe kjo pyetje e pergjithshme ku janë duke u përgatitur lista ka me dal dhe ju keni me votuar. Aty ka hapësirë edhe me kritikuar edhe me pas mirë edhe me pas keq. Aty jemi munduar me i përfshi gjitha fshatrat. Aty qe nuk janë të specifikuara kanë pasur vërejtje edhe na jemi kanë qe me qenë të specifikuara edhe te rrugët me zhavorr. Te shkolla nuk mundesh, te ura nuk mundesh, se duhet me ja thanë emrat. Ato nuk mund me i ndërrua, prioritet i jep kryetari me qeverinë, po dua me thanë se na duhet me qenë transparent me atë qe e thotë ligji, diskutimet publike, numri i punëtorëve në arsim. Unë nuk jam profesionist i kësaj lëmie, por atë me ramjen e numrit të nxënësve ka ra edhe numri i mësimeve. 620 punëtor të arsimit, por numri i pergjithshëm qe janë në listë të pagave 820 nuk na i ka zbritur hala, e kemi në listë atë buxhet e kemi.

**z.Bekim Azizi:** Kjo pak është ka gjysmë norme. Problemi në arsim është se, p.sh. në Ballancë edhe në Zhiti, ajo është një shkollë. Njërin i ke 5 nxënës, ndërsa tjetrin 4 nxënës. Parimisht një mësime duhet me i pasur 14 nxënës. Parimisht nëpër fshatra ti e ke normën, se nuk mund me i bart nxënësit nëpër fshatra tjera. Te na p.sh. ke në klasë të dymbëdhjetë i ka 9 nxënës. Na jena 74 mësime. A ne realitet na duhet me qenë 51 me këtë na 23 duhet me ecë prej shkolle.

**z.Ibrahim Rama:** Diskutimet publike. Unë kur kam organizuar ma herët një diskutim publik, me një fshat jam munduar me informuar qytetarët me njoftime publike. Ne askujt nuk mundemi me shkuar në shtëpi me i thanë. Duhet me dal ata qe kanë dashtë me dal, janë dal për afërsisht 1 mijë vetë i përcjellin debatet publike në nivel të komunës. Ndihamat sociale në shëndetësi. Krejt kjo shkon me fuqi financiare. Aty formohet një komision dhe i shqyrton kërkesat e qytetarëve.

**z.Berat Zuka:** Unë desha vetëm me plotësuar drejtorin. Se shumë pyetje u bënë për pagat jubilarë në qarkoren buxhetore, njësia financave. Jemi munduar na, e kemi ditur qe do ta ketë një kosto të madhe të pagave. Planifikimi i Drejtorisë së Arsimit i ka paraparë pagat jubilarë, pagat e rregullta, pagat përcjellëse, shujtat, edhe udhëtimin. Vetëm te arsimit fillor janë 298 mijë euro. Janë shujtat te arsimit i mesëm, është 85 mijë euro, mirëpo në konsultim me ekspertët na kanë apeluar qe mos të parashihen në buxhetin komunal, kurse për tri paga pas pensionimit është në qarkore.

**z.Bekim Azizi:** Desha të shtoj edhe diçka, megjithatë vendimi kur vjen nga gjykata paret kanë me ju marr komunës edhe e dimë se lëndët i kanë fituar krejt. Tash deri sa ta merr një vendim qeveria, paret kanë me ju marr nga buxheti i komunës.

**z.Jakup Demiri:** Te inspektimi i tregut, nuk pata sqarim. Sa i përket dëgjimeve publike, njoftimi nuk është bërë me kohë kurrë.

**z.Ibrahim Rama:** Unë thash krejt ato qe kemi bërë ndarjen, jemi konsultuar me drejtoritë përkatëse, unë po të them zyrtari për informim është këtu na në bazë të ligjit e njoftoj me kohë si në faqe të komunës

**Kryesuesi, z.Naim Pira:** Desha të them vetëm këtë, se me organizata të huaja qe e kanë monitoruar punën tonë, por edhe dëgjimet buxhetore. Shumë komuna kanë mbajtur vetëm dy takime buxhetore dhe kanë bërë në takime sa meshkuj edhe femra dhe janë dal ma të suksesshëm. Atëherë unë po ju falënderoj të gjithëve dhe kush është qe të ju rekomandohet kuvendit kjo pikë e rendit të ditës. Konstatoj se shkon për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër kemi:

### 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim-plotësim të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë

Fjalën ja kaloj nënkryetarit rreth kësaj pike.

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Na duhet me ja kthyer edhe me ja përshtat 20, por në praktikë ky imponim nuk shkon, se ke shumë katunde qe nuk donë me të përfaqësuar dikush tjetër.

**Kryesuesi, z.Naim Pira:** Kush është qe të shkoj për kuvend? Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.



Si pike te rendit te ditës kemi.

#### 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbështetje financiare për shpenzimet e strehimores "Liria" në Gjilan, për një periudhe trevjeçare, 2021-2022-2023

Urdhëro nënkryetar!

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Unë për shkak se edhe kam qenë në atë takim, të nderuar anëtar, ekziston një strehimore e regjistruar si OJQ në Gjilan, e cila gjithherë i kryen edhe obligimet edhe për qytetarët e Komunës së Vitisë dhe me ju thanë të drejtën, aty ma së shumti na kanë thanë ka nga Vitia dhe jep mjete ma së paku. Shuma e përgjithshme që ishte paraparë 15 mijë euro, se tjerat i ka qit ministria. Neve na i kanë caktuar 2500 euro dhe ju e dini që çka bien mbi 1 mijë euro duhet nga kuvendi.

**Kryesuesi, z.Naim Pira:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush?

**znj.Gjylsime Qamili:** Unë pajtoj me këtë ndarje të shumës, por në proporcion me numrin e banorëve që kërkojnë nuk është edhe e vogël.

**Kryesuesi, z.Naim Pira:** Atëherë kush është që të shkoj për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës? Konstatoj se shkon për kuvend edhe kjo pike. Dhe si pikë të fundit të rendit të ditës kemi:

#### 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2022

Na nuk e pamë të arsyeshme me i sjellë emrat këtu, ja lam kuvendit që secila parti politike e propozon nga një emër. E hedhim në votim që të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:55

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Naim Pira**

---





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

|                             |            |                    |                    |
|-----------------------------|------------|--------------------|--------------------|
| Pranuar - Prilajeno Më/Dana |            | 16.07-2021         |                    |
| Nr./Organiz.<br>Org.broj    | Numri/Broj | Shtetëse<br>Prilog | Vlera<br>Vrednosit |
| 02-402                      |            | 01-501             |                    |



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA



## Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2021

Viti 15.07.2021





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA



**DREJTORIA E FINANCAVE**

|                       |                                                                         |
|-----------------------|-------------------------------------------------------------------------|
| Data/Datum/Date       | 15.07.2021                                                              |
| Nr/Br.                |                                                                         |
| Për/Za/To             | Kuvendin e Komunës, Komitetin për Politikë dhe Financa                  |
| Përmes/Preko/Through  | Z. Sokol Haliti, Kryetar i Komunës                                      |
| Nga/Od/From           | Z. Ibrahim Rama, Drejtor i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim |
| Lënda/Predmet/Subject | Pasqyrat Financiare për periudhën janar-qershor 2021                    |

Bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi Financat Lokale si dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë paraqesim pasqyrat financiare të organizatës sonë buxhetore (657) për periudhën janar-qershor 2021 përfshirë të hyrat vetanake të realizuara si dhe shpenzimet buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike.

**Të hyrat**

Gjatë periudhës janar – qershor 2021 janë inkasuar gjithësej të hyra vetanake në vlerë prej 496.164,38€, shkalla e inkasimit, duke u bazuar në planifikimin vjetor është 57,61%, ndërsa krahasuar me të hyrat për periudhën janar – qershor të vitit 2020 të hyrat e vitit 2021 janë me të larta për 221.961,93 €

**Shpenzimet Buxhetore**

Buxheti i Alokuar për periudhën janar – qershor të vitit 2021 nga fondet burimore: Granti qeveritar, të hyrat vetanake, dhe donacionet janë: 7.170.964,51€, ndërsa shpenzimet janë: 5.391.790,68€, shkalla e ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar-qershor 2021 është 75,19% në krahasim me Alokimet për të gjitha programet dhe kategoritë ekonomike.

Në vazhdim të këtyre pasqyrave në mënyrë tabelare do të paraqesim shpenzimet buxhetore, duke i specifikuar sipas burimeve të financimit, programeve dhe kategorive Ekonomike.



# Buxheti i Aprovuar,Alokuar dhe i shpenzuar per te Gjitha programet buxhetore - janar-qershor 2021

## Aprovim

|   | <b>Kateg.&amp;Ekonomik</b> | Aprovime 10   | Aprovime 21 | Aprovimet 22 | Aprovimet Donacionet | Totali i Aprovimeve |
|---|----------------------------|---------------|-------------|--------------|----------------------|---------------------|
| 1 | Pagat &Shtesat             | 7,625,412.41  | 0.00        | 0.00         | 881.90               | 7,626,294.31        |
| 2 | Mall.&Sherbime             | 1,773,949.00  | 145,000.00  | 66,093.66    | 1,908.82             | 1,986,951.48        |
| 3 | Komunali                   | 320,000.00    | 0.00        | 0.00         | 0.00                 | 320,000.00          |
| 4 | Subvencione                | 4,000.00      | 350,000.00  | 59,849.68    | 14.31                | 413,863.99          |
| 5 | Kapitale                   | 2,068,382.00  | 366,250.00  | 63,777.79    | 5,326.07             | 2,503,735.86        |
|   |                            | 11,791,743.41 | 861,250.00  | 189,721.13   | 8,131.10             | 12,850,845.64       |

## Alokimet

|   | <b>Kateg.&amp;Ekonomik</b> | Alokimet 10  | Alokimet 21 | Alokimet22 | Alokimet Donacionet | Totali i Alokimeve |
|---|----------------------------|--------------|-------------|------------|---------------------|--------------------|
| 1 | Pagat &Shtesat             | 3,900,859.97 | 0.00        | 0.00       | 881.90              | 3,901,741.87       |
| 2 | Mall.&Sherbime             | 1,010,001.00 | 4,000.00    | 66,093.66  | 1,908.82            | 1,082,003.48       |
| 3 | Komunali                   | 168,500.00   | 0.00        | 0.00       | 0.00                | 168,500.00         |
| 4 | Subvencione                | 4,000.00     | 70,000.00   | 59,849.68  | 14.31               | 133,863.99         |
| 5 | Kapitale                   | 1,488,382.00 | 327,369.31  | 63,777.79  | 5,326.07            | 1,884,855.17       |
|   |                            | 6,571,742.97 | 401,369.31  | 189,721.13 | 8,131.10            | 7,170,964.51       |

## Te paalokuara

|   | <b>Kateg.&amp;Ekonomik</b> | Alokimet 10  | Alokimet 21 | Alokimet22 | Alokimet Donacionet | Totali i Alokimeve |
|---|----------------------------|--------------|-------------|------------|---------------------|--------------------|
| 1 | Pagat &Shtesat             | 3,724,552.44 | 0.00        | 0.00       | 0.00                | 3,724,552.44       |
| 2 | Mall.&Sherbime             | 763,948.00   | 141,000.00  | 0.00       | 0.00                | 904,948.00         |
| 3 | Komunali                   | 151,500.00   | 0.00        | 0.00       | 0.00                | 151,500.00         |
| 4 | Subvencione                | 0.00         | 280,000.00  | 0.00       | 0.00                | 280,000.00         |
| 5 | Kapitale                   | 580,000.00   | 38,880.69   | 0.00       | 0.00                | 618,880.69         |
|   |                            | 5,220,000.44 | 459,880.69  | 0.00       | 0.00                | 5,679,881.13       |

## Shpenzimet

|   | <b>Kateg.&amp;Ekonomik</b> | Shpenzimet 10 | Shpenzimet 21 | Shpenzimet 22 | Shpenzimet Donacionet | Totali i Shpenzimeve | % shpenzimit |
|---|----------------------------|---------------|---------------|---------------|-----------------------|----------------------|--------------|
| 1 | Pagat &Shtesat             | 3,894,875.71  | 0.00          | 0.00          | 0.00                  | 3,894,875.71         | 99.82%       |
| 2 | Mall.&Sherbime             | 457,762.40    | 845.00        | 50.00         | 0.00                  | 458,657.40           | 42.39%       |
| 3 | Komunali                   | 117,424.41    | 0.00          | 0.00          | 0.00                  | 117,424.41           | 69.69%       |
| 4 | Subvencione                | 4,000.00      | 38,079.20     | 7,970.00      | 0.00                  | 50,049.20            | 37.39%       |
| 5 | Kapitale                   | 796,055.64    | 69,416.82     | 0.00          | 5,311.50              | 870,783.96           | 46.20%       |
|   |                            | 5,270,118.16  | 108,341.02    | 8,020.00      | 5,311.50              | 5,391,790.68         | 75.19%       |

## Diferenca Alokim-Shpenzim

|   | <b>Kateg.&amp;Ekonomik</b> | Shpenzimet 10 | Shpenzimet 21 | Shpenzimet 22 | Shpenzimet Donacionet | Totali i Shpenzimeve |
|---|----------------------------|---------------|---------------|---------------|-----------------------|----------------------|
| 1 | Pagat &Shtesat             | 5,984.26      | 0.00          | 0.00          | 881.90                | 6,866.16             |
| 2 | Mall.&Sherbime             | 552,238.60    | 3,155.00      | 66,043.66     | 1,908.82              | 623,346.08           |
| 3 | Komunali                   | 51,075.59     | 0.00          | 0.00          | 0.00                  | 51,075.59            |
| 4 | Subvencione                | 0.00          | 31,920.80     | 51,879.68     | 14.31                 | 83,814.79            |
| 5 | Kapitale                   | 692,326.36    | 257,952.49    | 63,777.79     | 14.57                 | 1,014,071.21         |
|   |                            | 1,301,624.81  | 293,028.29    | 181,701.13    | 2,819.60              | 1,779,173.83         |

## Diferenca Aprovim-Shpenzim

|   | <b>Kateg.&amp;Ekonomik</b> | Shpenzimet 10 | Shpenzimet 21 | Shpenzimet 22 | Shpenzimet Donacionet | Totali i Shpenzimeve |
|---|----------------------------|---------------|---------------|---------------|-----------------------|----------------------|
| 1 | Pagat &Shtesat             | 3,730,536.70  | 0.00          | 0.00          | 881.90                | 3,731,418.60         |
| 2 | Mall.&Sherbime             | 1,316,186.60  | 144,155.00    | 66,043.66     | 1,908.82              | 1,528,294.08         |
| 3 | Komunali                   | 202,575.59    | 0.00          | 0.00          | 0.00                  | 202,575.59           |
| 4 | Subvencione                | 0.00          | 311,920.80    | 51,879.68     | 14.31                 | 363,814.79           |
| 5 | Kapitale                   | 1,272,326.36  | 296,833.18    | 63,777.79     | 14.57                 | 1,632,951.90         |
|   |                            | 6,521,625.25  | 752,908.98    | 181,701.13    | 2,819.60              | 7,459,054.96         |



## Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit për të gjitha njësit buxhetore

| Nr | Emërtimi                   | Buxheti i aprovuar     | Alokimet e buxhetit   | Shpenzimet            | Buxheti i pa shpenzuar | Alokimi i pa shpenzuar | %             |
|----|----------------------------|------------------------|-----------------------|-----------------------|------------------------|------------------------|---------------|
| 1  | Kompensimi i të punësuarve | 7,626,294.31           | 3,901,741.87          | 3,894,875.71          | 3,731,418.60           | 6,866.16               | 99.82%        |
| 2  | Mallra dhe shërbime        | 1,986,951.48           | 1,082,003.48          | 458,657.40            | 1,528,294.08           | 623,346.08             | 42.39%        |
| 3  | Subvencione                | 413,863.99             | 133,863.99            | 50,049.20             | 363,814.79             | 83,814.79              | 37.39%        |
| 4  | Komunali                   | 320,000.00             | 168,500.00            | 117,424.41            | 202,575.59             | 51,075.59              | 69.69%        |
| 5  | Shpenzime kapitale         | 2,503,735.86           | 1,884,855.17          | 870,783.96            | 1,632,951.90           | 1,014,071.21           | 46.20%        |
|    | <b>Gjithesëjt</b>          | <b>12,850,845.64 €</b> | <b>7,170,964.51 €</b> | <b>5,391,790.68 €</b> | <b>7,459,054.96 €</b>  | <b>1,779,173.83 €</b>  | <b>75.19%</b> |

## Shpenzimet për të gjitha njësit buxhetore

| Kodi  | Përshkrimi                            | Shuma               |
|-------|---------------------------------------|---------------------|
| 11110 | Paga neto                             | 3,211,550.75        |
| 11500 | Tatimi në paga                        | 193,952.86          |
| 11600 | Kontributi i punëtorit                | 180,327.71          |
| 11700 | Kontributi i punëdhënsit              | 180,327.71          |
| 11115 | Sindikata                             | 16,480.08           |
| 11125 | OIK                                   | 1,230.12            |
| 11126 | OMK                                   | 2,000.00            |
| 11900 | Pagesa per vendime gjyqesore          | 109,006.48          |
|       | <b>Totali i pagave</b>                | <b>3,894,875.71</b> |
| 13130 | Shpenzimet e udhëtimit mbrenda vendit | 5,580.50            |
| 13210 | Shpenzimet e rrymës                   | 82,901.83           |
| 13220 | Shpenzimet e ujit                     | 14,357.47           |
| 13230 | Shpenzimet e mbeturinave              | 15,847.10           |
| 13250 | Shpenzimet e telefonis fikse          | 4,318.01            |
| 13310 | Shpenzimet per internet               | 411.57              |
| 13320 | Shpenzimet e telefonis mobile         | 7,459.05            |
| 13430 | Sherbime te ndryshme shendetesore     | 92,273.32           |
| 13450 | Sherbime shtypje - jo marketing       | 1,431.28            |
| 13460 | Sherbime Kontraktuese tjera           | 41,276.61           |
| 13470 | Sherbime teknike                      | 1,365.00            |
| 13480 | Shpenzimet per antaresim              | 7,048.05            |
| 13501 | Furnizimi me inventar                 | 400.00              |
| 13509 | Pajisje tjera                         | 34,740.00           |
| 13610 | Furnizime për zyre                    | 17,317.37           |



|       |                                                 |                       |
|-------|-------------------------------------------------|-----------------------|
| 13620 | Furnizime me ushqim dhe pije                    | 2,567.27              |
| 13630 | Fur nizime mjekesore                            | 2,939.00              |
| 13640 | Furnizime pastrimi                              | 2,860.25              |
| 13650 | Furnizimi me veshmbathje                        | 300.00                |
| 13720 | Naftë për ngrohje qendrore                      | 14,904.91             |
| 13760 | Furnizim me lende djegëse (Dru)                 | 4,950.50              |
| 13770 | Derivate për gjenerator                         | 473.24                |
| 13780 | Derivate veturave                               | 8,608.48              |
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve                       | 1,690.00              |
| 13951 | Sigurimi i automjeteve                          | 1,907.65              |
| 14010 | Mirembatja dhe riparim i automjeteve            | 10,671.00             |
| 14020 | Mirembatja e ndertesave                         | 80,337.14             |
| 14032 | Mirembatja e autorrugeve lokale                 | 76,180.98             |
| 14040 | Mirembatja e teknologjis informative            | 1,886.00              |
| 14050 | Mirembatje e mobileve dhe paisjeve              | 355.00                |
| 14060 | Mirembatja rutinore                             | 8,720.00              |
| 14220 | Botimet e publikimeve                           | 5,510.00              |
| 14230 | shpenzimet për informim publik                  | 5,806.50              |
| 14310 | Dreka zyrtare                                   | 6,264.30              |
| 14410 | Shpenzime - vendimet e gjykatave                | 12,422.43             |
|       | <b>Totali për shërbimeve mallra dhe komunal</b> | <b>576,081.81</b>     |
| 200   | Subvencionet dhe transfere                      | 50,049.20             |
|       | <b>Totali i subvencioneve</b>                   | <b>50,049.20</b>      |
| 300   | Investime kapitale                              | 870,783.96            |
|       | <b>Tatali i investimeve kapitale</b>            | <b>870,783.96</b>     |
|       | <b>Gjithsej shpenzimet</b>                      | <b>5,391,790.68 €</b> |



| Nr | Emërtimi                   | Buxheti i aprovuar | Alokimet e buxhetit | Shpenzimet   | Buxheti i pa shpenzuar | Alokimi i pa shpenzuar | %       |
|----|----------------------------|--------------------|---------------------|--------------|------------------------|------------------------|---------|
| 1  | Kompensimi i të punësuarve | 286,179.99         | 144,248.81          | 144,248.81   | 141,931.18             | 0.00                   | 100.00% |
| 2  | Mallra dhe shërbime        | 137,549.97         | 76,549.97           | 36,851.41    | 100,698.56             | 39,698.56              | 48.14%  |
| 3  | Subvencione                | 128,345.22         | 47,345.22           | 19,760.00    | 108,585.22             | 27,585.22              | 41.74%  |
| 4  | Komunali                   | 0.00               | 0.00                | 0.00         | 0.00                   | 0.00                   | #DIV/0! |
| 5  | Shpenzime kapitale         | 0.00               | 0.00                | 0.00         | 0.00                   | 0.00                   | #DIV/0! |
|    | Gjithsej                   | 552,075.18 €       | 268,144.00 €        | 200,860.22 € | 351,214.96 €           | 67,283.78 €            | 74.91%  |

Shpenzimet e Zyres Kryetarit 16033

| Kodi  | Përshkrimi                            | Shuma               |
|-------|---------------------------------------|---------------------|
| 11110 | Paga neto                             | 116,018.76          |
| 11500 | Tatimi në paga                        | 7,799.02            |
| 11600 | Kontributi i punëtorit                | 6,526.42            |
| 11700 | Kontributi i punëdhënsit              | 6,526.42            |
| 11115 | Sindikata                             | 180.99              |
| 11900 | Pagesa per vendime gjyqesore          | 7,197.20            |
|       | <b>Totali i pagave</b>                | <b>144,248.81</b>   |
| 13450 | Sherbime shtypje - jo marketing       | 992.33              |
| 13460 | Sherbime kontraktuese tjera           | 13,868.45           |
| 13480 | Shpenzimet per antaresim              | 7,048.05            |
| 13610 | Furnizime per zyre                    | 1,821.86            |
| 14010 | Mirembatja dhe riparimi i automjeteve | 310.00              |
| 14040 | Mirembatje e teknologjis informative  | 406.00              |
| 14220 | Botimet e publikimeve                 | 5,510.00            |
| 14230 | shpenzimet per informim publik        | 1,275.46            |
| 14310 | Dreka zyrtare                         | 1,054.00            |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave        | 4,565.26            |
|       |                                       |                     |
|       |                                       |                     |
|       | <b>Totali për shërbime dhe mallra</b> | <b>36,851.41</b>    |
| 200   | Subvencione dhe transfere             | 19,760.00           |
